



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR VLORE HIMARË

Nr 1971 Prot

Datë 20.09.2024

**SHPALLJE PËR APLIKIM SI MËSUES KOORDINATOR TË KËSHILLIMIT TË
KARRIERËS DHE MËSUES KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË**

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 27.2.2019, "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" i ndryshuar, Urdhërit Nr. 463, datë 30.08.2024, "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shkresës Nr. 5367/3 prot., datë 04.09.2024, "Mbi zbatimin Urdhërit Nr. 463, datë 30.08.2024 "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës" në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe shkresës nr 2946/23 dt 18.09.2024, të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, mbi numrin e miratuar të mësuesve koordinatorë për sigurimin e cilësisë dhe mësuesve koordinatorë të këshillimit të karrierës.

Ju njoftojmë se shpallen procedurat e konkurrimit të mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës.

A) Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për mësues koordinator për sigurimin e cilësisë:

- Duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor me kontratë pa afat dhe të ketë 8 vite punë si mësues, nga të cilat 5 vite në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të sigurimit të cilësisë ose në shkollën me numër më të madh nxënësish.
- Të ketë kategorinë "Mësues specialist" me rezultat "Shumë mire" ose "Shkëlqyeshëm". Avantazh përbën rezultati "Shkëlqyeshëm".
- Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësimin "Shumë mire" për tri vite radhazi.
- Të ketë kryer prezantimin e një projekti novator për zhvillimin e lëndës, që dëshmohet nga institucioni arsimor përkatës.
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.

B) Dokumentacioni që duhet të dorëzojë:

- Kërkesë me shkrim,
- Jetëshkrim,

- c) Kopje të diplomave dhe listës së notave,
- d) Librezë pune ose vërtetim pune,
- e) Kopje të certifikatës së kualifikimit të fundit,
- f) Vlerësimet e punës së tre viteve të fundit,
- g) Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj (anglisht),
- h) Çertifikatë apo dëshmi të njohurive të programeve kryesore kompjuterike,
- i) Prezantimi i projektit novator për zhvillimin e lëndës, që dëshmohet nga institucioni arsimor përkatës,
- j) Certifikata, trajnime ose rekomandime që dëshmojnë njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve,
- k) Deklaratë për vërtetësinë e dokumentave,
- l) Deklaratë e konfliktit të interesit,
- m) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.

C) Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për mësues koordinator për këshillimin e karrierës:

- a) Duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor dhe të ketë 5 vite punë si mësues, ndër të cilat 3 vite si mësues në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të këshillimit të karrierës ose në shkollën me numër më të madh nxënësish.
- b) Të ketë përfituar kategorinë "Mësues i kualifikuar" me rezultat "Shumë mire" ose "Shkëlqyeshëm". Avantazh përbën rezultati "Shkëlqyeshëm".
- c) Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësimin "Shumë mire" për dy vite radhazi.
- d) Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve, të cituara në vlerësimet periodike të mësuesit në shkollë apo certifikata në trajnime.
- e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.

D) Dokumentacioni që duhet të dorëzojë:

- a) Kërkesë me shkrim,
- b) Jetëshkrim,
- c) Kopje të diplomave dhe listës së notave,
- d) Librezë pune ose vërtetim pune,
- e) Kopje të certifikatës së kualifikimit të fundit,
- f) Vlerësimet e punës së dy viteve të fundit,
- g) Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj (anglisht),
- h) Çertifikatë apo dëshmi të njohurive të programeve kryesore kompjuterike,
- i) Certifikata, trajnime ose rekomandime që dëshmojnë njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve,
- j) Deklaratë për vërtetësinë e dokumentave,



k) Deklaratë e konfliktit të interesit,

l) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.

Aplikimet për këto dy pozicione bëhen prej datës 20.09.2024 deri 25.09.2024.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dosjen me elementët e detyrueshëm në ZVAP VLORE HIMARË.